



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më
24.6.2015, e cila filloi në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Hatixhe Hoxha përfaqësuese e LVV-së, Imer Rusinovci, shef i GP-së (AAK), Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së, Islam Pacolli, shef i GP-së (AKR) dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

Munguan: Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së dhe Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së.

Morën pjesë edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Visar Berisha, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës, Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Hysen Durmishi, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, përfaqësues të mediave dhe përfaqësues të INPO-së.

Mbledhjen e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Komitetit.

Para se të fillonin diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Kryesuesi** propozoi që pikë e parë e rendit të ditës të jetë - Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë, pasi erdhi si plotësim se nuk ka qenë pikë e rendit të ditës.

Sami Hamiti tha se sa i përket rendit të ditës, e kanë marrë një pjesë të materialit ndërsa për shqyrtimin e Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, materialin nuk e kanë, e në rend dite ka qenë, nuk janë njoftuar se a do të jetë pikë e rendit a jo, ndërsa sa i përket pikave që vijnë nga Urbanizmi dhe janë hequr në Kuvend, nuk do t'i debatohet. Ai bëri vërejtje që materialet të mos u dërgohen pa qenë komplet.

Dardan Sejdiu, sa i përket shqyrtimit të Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, pse nuk është sot këtu, mund të justifikohet edhe nga anëtarët e subjekteve të tjera politike. Ai bëri të ditur se kanë pasur një takim me kryeministrin, z. Isa Mustafa, dhe ministrin e Financave, z. Abdullah Hoti, zëvendësministrin, z. Kujtim Shala, dhe nëpunës të tjerë të Kabinetit të Kryeministrit, dhe janë pajtuar që të ecin përpara gjatë këtij viti me Ligjin për Prishtinën. Për këtë ligj nevojitet një grand shtesë, andaj si ekzekutiv, së bashku me një pjesë të kabinetit, para se ta sjellim Kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, janë pajtuar se si do të dukej ky grant dhe meqë qarkorja buxhetore nuk e ka parasysh këtë grant, rrjedhimisht është në shpërputhje me planet. Andaj, ekzekutivi, së bashku me ministrinë përkatëse, është që të diskutojnë, për të ardhur deri te pajtimi se si do ta trajtojnë këtë grant shtesë para se të sjellin për shqyrtim Kornizën afatmesme buxhetore, rrjedhimisht është kjo pse nuk është sot Korniza afatmesme buxhetore.

Sa i përket pikave që vijnë nga Drejtoria e Urbanizmit, theksoi se e kupton që është qëndrim politik, por edhe ata e kanë qëndrimin e tyre që t'i qesin pikat në rend dite, pastaj në Kuvend të vendoset a të diskutohet dhe të merret vendim lidhur me këto pika. Sa i përket pikave 6 dhe 7 (sipas rendit të ditës të propozuar) - Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, dhe - Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, nuk ka asnjë pengesë që të procedohen më tutje, sepse janë kryer të gjitha obligimet lidhur me këto dy propozimvendime.

Kryesuesi tha se e kanë futur në rend dite pikën - Shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore, mirëpo është dashur më herët të njoftohen për këtë pikë se nuk do të jetë në rend dite, pasi nuk kanë material, në mënyrë që t'i njoftojë anëtarët e KPF-së, se ka qenë pikë e rendit të ditës, por këto janë arsytet pse nuk është materiali.

Sami Hamiti u shpreh se takimi me kryeministrin Mustafa paska qenë para dy javësh, ndërsa materiali ju është dërguar para 4 - 5 ditëve dhe ju është thënë se do t'iu dërgojnë materialin.

Qëndron Kastrati lidhur me rendin e ditës, tha se është propozim i GP-së së Vetëvendosjes që materiali të ndahet në mbledhje të Kuvendit në dy pjesë, sepse ka shumë pika, kanë edhe përmbajtje që mund të zgjas takimin.

Sa i përket propozimit të Samiut, që të hiqen disa pika të rendit të ditës, ka të bëjë me pika të rëndësishme, siç është aspekti i planifikimit të Komunës së Prishtinës dhe aspekti i ndihmës në zhvillimin ekonomik, si dhe të planeve rregulluese, andaj i propozoj ekzekutivit që nëse këto pika vazhdimisht nuk trajtohen, atëherë nuk do të ketë mbledhje të Kuvendit. Sa i përket shkarkimit të një drejtori, mendojmë se një gjë e tillë nuk është kompetencë e këshilltarëve komunalë.

Laura Zherka lidhur me rendin e ditës, tha se e kanë qëndrimin politik parësor, që për pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7, të mos i trajtojnë dhe shqyrtojnë, ndërsa për pikën e parë lidhur me kornizën afatmesme buxhetore, tha se z. nënkryetar nuk mund t'i bindë me justifikimin pse nuk është

sjellë ky dokument. Ky është dokument strategjik dhe duhet zbatuar brenda periudhës 2-3 vjeçare. Dihet se dokumentet strategjike mund të ndryshohen.

Justifikimi që kanë vendosur pak para se me ardhur në takim mos me e sjellë materialin, është dashur së paku të kishin informuar, me e dhënë një arsytim se kjo pikë e rendit nuk do të silllet në KPF, çka këto nuk i konsideron arsye, sepse nuk është më koha e centralizmit që ato të miratohen dhe të mos mund të ndryshohen.

Islam Pacolli tha se ka shumë pika të rendit të ditës, e shumë nga to nuk po shqyrtohen, nga fundi i takimit po mbesin pak asamblastë dhe nuk është e ligjshme kur është numri i vogël për disa pika. Për pikat që nuk po mund të futen në rend dite në KPF, që po mbesin për t'u diskutuar në pikën - Të ndryshme, nuk po kanë mundësi me dhënë kontributin e tyre, andaj kishte qenë mirë të ndahen në dy ditë këto pika që të mund të diskutojnë.

Ai tha se në pikën - Të ndryshme, do ta bëjë temë çështjen e ndërprerjes së punimeve të rrugës në Hajvali, ku kanë pasur takim me drejtorin e Infrastrukturës, z. Hysen Durmishi, dhe pas asaj ka lexuar një tekst, ku thuhej se është problemi i tij pse është ndërprerë rruga.

Imer Rusinovci përkrahu mendimin se duhet të procedohet ky rend dite.

Dardan Sejdiu propozoi që pika e parë (sipas rendit të ditës të propozuar), - Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi tha se sa i përket shqyrtimit të kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016-2018, mendoj se duhet të hiqet nga rendi i ditës, ndërsa për pikën e 6-të dhe të 7-të, janë pika që janë shqyrtuar në KPF dhe mund të shkojnë si pika në Kuvend, pastaj në Kuvend të vendoset a të diskutohet dhe merret vendim lidhur me këto pika.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës, ku u konstatua se pika 1 hiqet, ndërsa pikat 3,4,5,6,7 shkojnë si pika në Kuvend, ku më pas në Kuvend do të vendoset se a të diskutohet dhe merret vendim lidhur me këto pika.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky

RENDI I DITËS :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë;
2. Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015;
3. Propozimvendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
4. Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1";
5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër;
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë;
8. Propozimrregullorja për rrugët komunale;
9. Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore;

10. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Hortikultura";
11. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës;
12. Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës;
13. Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë (KUR "Prishtina" NPL);
14. Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve;
15. Të ndryshme.

Pika e parë

Dardan Sejdiu bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, duke thënë se në faqen 2, në pjesën e diskutimit të tij, ku thuhet se ankesa është bërë, t'i bashkëngjitet "janë në dijeni për rastin" dhe kanë kërkuar nga ankuesi që të jepet emri i personit zyrtar që pretendohet ta ketë fyer atë dhe të ndërmerren masa ndaj tij".

Kryesuesi konstatoi se me plotësimin e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.

Dardan Sejdiu tha se kërkesë e KPF-së ka qenë që në mbledhje të jetë i pranishëm drejtori ose përfaqësuesit e drejtorive përkatëse për pikat që u takojnë të referojnë, andaj **Visar Berisha** do të informojë lidhur me Propozimvendimin për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.

Visar Berisha dha sqarime, duke thënë se është fjala për një shumë prej 159,550 €, ku Komuna e Prishtinës propozon që në kuadër të rregullimit të ndarjeve buxhetore, të transferojë 5% të buxhetit nga mallrat dhe shërbimet (159,550 €) në subvencione dhe transfere për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2015 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për miratimin - lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues të lagjes "Kalabria".

Pika e katërt

Propozimvendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues të lagjes "Mati 1".

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues të lagjes “Lakërishta” në Prishtinë.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë.

Këto pika të rendit të ditës: pika e tretë, pika e katërt, pika e pestë, pika e gjashtë dhe pika e shtatë dërgohen në Kuvend, ku do të vendoset a të diskutohet, dhe merret vendim lidhur me këto pika.

Pika e tetë

Propozimrregullorja për rrugët komunale.

Hysen Durmishi informoi lidhur me **Propozimrregulloren për rrugët komunale**. Ai tha se kjo rregullore është punuar brenda gjashtë muajve nga 4 drejtori: Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspeksionit. Kjo rregullore i ka 37 nene dhe është shumë e rëndësishme nëse kalon në Kuvend.

Qëndron Kastrati propozoi që propozimrregullorja për rrugët komunale dhe Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore, të dërgohen për diskutim publik.

Hysen Durmishi propozoi që të përcillet në Kuvend, pastaj të dërgohet në diskutim publik.

Islam Pacolli përkrahu dërgimin në diskutim publik, sepse është rregullore e domosdoshme.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për rrugët komunale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e nëntë

Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore.

Dardan Sejdiu tha se Drejtoria e Arsimit ka përgatitur një rregullore, që do ta ndihmojë Komunën e Prishtinës në organizimin e procesit edukativo-arsimor.

Arbërie Nagavci theksoi se qëllimi i kësaj rregulloreje është të funksionojë mirë procesi në institucionet edukativo-arsimore.

Në këtë dokument janë paraparë të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë prej drejtorit deri te nxënësi, janë caktuar edhe masat disiplinore që do të ndërmerren ndaj atyre që nuk i respektojnë këto rregulla.

Kryesuesi sugjeroi që të ndahet rregullorja në çështjet që kanë të bëjnë me nxënësit.

Hazir Borovci e falënderoi drejtoreshën dhe stafin për këtë rregullore që kanë hartuar. Ai shprehu mendimin se kjo rregullore është e zgjeruar, dhe e përkrahu procedimin e saj për Kuvend.

Qëndron Kastrati në parim e përkrahu dërgimin e Propozimrregullores në Kuvend, ndërsa nenin 55 mbetet ta trajtojë në Kuvend.

Arbërie Nagavci shprehu mendimin që drejtorët duhet ta ndajnë pjesën që është me rëndësi, si p.sh. për nxënës t'u jepet pjesa e tyre.

Laura Zherka sugjeroi që të ndahen disa broshura, në mënyrë që të kenë njohuri nxënësi dhe mësimdhënësi për të drejtat dhe përgjegjësit e tyre.

Kryesuesi propozoi që të jenë dy broshura, një për stafin e shkollës, një për nxënës.

Dardan Sejdiu u shpreh i pajtimit me propozimin e parafolësve që të ndahen disa broshura, që secili t'i dijë të drejtat dhe përgjegjësitë e veta. Me miratimin e kësaj rregulloreje, duhet të fillojnë me ndarje në tri-katër pjesë me broshura.

Arbërie Nagavci tha se në shtator do t'u jepet të gjithëve në formë broshure.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për organizimin e punës në institucionet edukativo-arsimore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Hortikultura".

Ardian Gashi dha sqarime lidhur me **Propozimvendimin për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Hortikultura"**. Ai tha se është fjala për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të përkohshëm NPL "Hortikultura", ku qëllimi është mirëmbajtja dhe ngritja e sipërfaqeve të gjelbëruara në komunën e Prishtinës.

Visar Berisha propozoi që të bëhet një përmirësim, aty ku e kemi: **Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim të përkohshëm, të hiqet fjala "përkohshme" dhe të zëvendësohet me fjalën "afatshkurtër" NPL "Hortikultura"**.

Kryesuesi tha të përcillet në Kuvend, mirëpo duhet ekzekutivi të ketë takim me MPL-në, të konsultohen se kush është trashëgimtar i këtyre parcelave para Kuvendit, në mënyrë që të hiqet dilema.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër NPL "Hortikultura" dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Faqe 6 nga 8

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës.

Visar Berisha tha se është fjala për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës, afati kohor për dhënien në shfrytëzim është afatshkurtër, në periudhën për 10 vjet.

Në vendim ku është cekur se afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është afatshkurtër, në periudhën për 15 vjet, të përmirësohet dhe të jetë *“për 10 vjet”*.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të Komunës së Prishtinës, Prokurorisë së Shtetit të Republikës së Kosovës, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e dymbëdhjetë

Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës.

Ardian Gashi informoi se shërbimet e mbledhjes së mbeturinave në Prishtinë realizohen nga kompania *“Prishtina”*. Përveç mbledhjes së mbeturinave, kjo kompani ofron edhe shërbime të pastrimit të rrugëve, si dhe shërbime të sezonit të dimrit, si punë sekondare. Komuna ballafaqohet edhe me problemin e mbeturinave inerte nga ndërtimet dhe renovimet e objekteve, të cilat hidhen kudo në pronat komunale. Për zgjidhjen e këtij problemi Komuna ka hartuar projektin për deponinë e mbeturinave inerte në Hajvali. Pas kryerjes së procedurave, do të ndërtohet deponia, e cila përfundimisht e zgjidh problemin me mbeturina inerte.

Islam Pacolli tha se nuk është mirë të bëhet ndërtimi i deponisë së mbeturinave inerte afër liqenit, sepse ndotet liqeni. Ai shprehu mendimin që buzë liqenit duhet të ketë kampe të sportit e jo deponi të mbeturinave.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e trembëdhjetë

Informatë për gjendjen e furnizimit me ujë (KUR “Prishtina” NPL).

Kryesuesi theksoi se sa i përket kësaj informate, përfaqësuesi i KUR “Prishtina” NPL do të informojë në Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata për gjendjen e furnizimit me ujë (KUR “Prishtina” NPL) dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e katërbëdhjetë

Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve.

Ardian Gashi informoi lidhur me menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve, duke thënë se janë duke u mirëmbajtur mbi 100 ha hapësirë gjelbëruese, janë mbjellë fidanë të rinj, lule sezonale, drurë dekorativë, në 17 puse janë instaluar pompat për ujitje etj.

Për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave është angazhuar ndërmarrja "Hortikultura".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Informata mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e pesëmbëdhjetë

Të ndryshme

Islam Pacolli e paraqiti problemin e rrugës në Hajvali, që ka kohë që nuk po punohet dhe nuk janë duke u kryer punimet sipas projektit. Ai ceku se ka pasur takim me drejtorin e Infrastrukturës Lokale lidhur me këtë çështje. Ai shprehu shqetësimin e tij se në gazetën ditore "Zëri" ka dalë një artikull, ku thuhet se ai e ka marrë për sipër që rrugët që janë me probleme do t'i zgjidhë ai me banorë. Lidhur me këtë apeloj që të mos dilet me deklaratat të tilla në opinion, sepse nuk janë të sakta. Nëse ka nevojë për një përkrahje, mund të ketë një donacion, por çështja është se nuk është duke u punuar e gjendja është e rrezikshme. Sa i përket drejtorit të Infrastrukturës, deklaratat e tij nuk janë sakta.

Dardan Sejdiu u interesua lidhur me këtë çështje dhe e pyeti përfaqësuesin e gazetës ditore "Zëri" për sqarime lidhur me këtë çështje.

Përfaqësuesi i gazetës "Zëri" Mentor Buzhala, dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Hazir Borovci e pyeti drejtoreshën e Arsimit se nxënësit që kanë mbaruar shkollimin në komuna të tjera, kurse me vendbanim janë në Prishtinë, si është vepruar me ta për regjistrim.

Arbërie Nagavci dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Hazir Borovci sugjeroi që kryetari, nënkryetari, kryesuesi dhe shefat e GP -ve, të kenë angazhim konkret rreth tejkalimit të mosmarrëveshjeve dhe të vendoset për çdo gjë që shkon në interes të qytetarëve pa ngarkesa individuale apo politike.

Imer Rusinovci shtroi çështjen se disa qytetarë po qëndrojnë pranë hyrjes së Komunës dhe po shprehin shqetësimin e tyre se nuk po trajtohen nga Komuna.

Dardan Sejdiu bëri të ditur se ata janë informuar se nuk mund të veprojnë jashtë ligjit.

Mbledhja përfundoi në orën 16:40.

Procesmbajtës:
Zijadin Gashi dhe
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.